




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.201/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje z.Blerim Dina– Kryetar, z.Nuhi Paçarizi –Referues, z.Goran Milenković –Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik OE “Marimanga” - Prishtinë, me nr. të protokolli 201/19, e datës: 06.05.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shërbimet e transportit me merimanga –Ritender Lot 1” me nr. të prokurimi: AP:616-18-8971-2-1-1, të shpallur nga autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës, më datën 14.05.2019 mori këtë:

VENDIM

I.Hedhet si e pa lejuar ankesa e OE“Marimanga” - Prishtinë, me nr. të protokolli 201/19, e datës : 06.05.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shërbimet e transportit me merimanga –Ritender Lot 1” me nr. të prokurimi: AP:616-18-8971-2-1-1, të shpallur nga autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës , pasi që ankuesi nuk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-së në autoriteti kontraktues.

II.I LEJOHET autoritetit kontraktues–Komuna e Prishtinës që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shërbimet e transportit me merimanga –Ritender Lot 1” me nr. të prokurimi: AP:616-18-8971-2-1-1 , përkitazi me këtë ankesë,(nëse nuk ka ankesë tjetër).

III. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është e lejuar sipas nenit 108/A të LPP-së dhe nenit 3.3 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave .Po ashtu e njëjta ankesë nuk është e kompletuar sepse OE ankues nuk ka arritur të kryej tarifën pagesën sipas tarifave të parashtrimi të ankesave në OSHP.

ARSYETIM

Më datën 06 05J 2019 Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana e OE “Merimanga” SH.P.K.Prishtinë, me nr. te protokollit 201/19kundër njoftimit për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit:“Shërbimet e transportit me merimanga –Ritender Lot 1” me nr. të prokurimi: AP:616-18-8971-2-1-1.

Me datë 22.03.2019 AK-Komuna e Prishtinës i ka dërguar Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar OE “Marimanga” SHPK Prishtinë.

Me date 27.03.2019, OE ankues ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim në AK KK Prishtine

Me dt.27.03.2019, nga ana e AK KK Prishtinë është bere pezullimi i aktivitetit te prokurimit ne fjalë.

Me datën :29.03.2019, AK i dërgon OE ankues vendimin për aprovim te pjesshëm te kërkesës për rishqyrtim dhe aktivitetin e prokurimit në fjale e kthen në rivlerësim.

Mbas rivlerësimit AK me datë:25.04.2019, dërgon OE-ve Letrën standarde për eliminim dhe Njoftimin/ Vendimin për dhëni te kontratës.

Operatori ekonomik rekomanduar për dhënie të kontratës është OE “Dreni-A”SHPK Prishtinë.

KundërLetrës standarde për eliminim dhe Njoftimit/ Vendimit për dhëni te kontratës te datës:25.04.2019 OE ankues nuk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim te këtyre vendimeve brenda periudhës kohore prej 5 ditëve ashtu siç parashihet me nenin 4 paragrafi 1 pika (b) Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, në të cilin thuhet: Kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet te dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme: Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për dhënie të një kontratë ose te një konkursi te projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit te projektimit që i është dërguar ankuesit.

Në kundërshtim me neni e lartcekur OE “Marimanga” SHPK me datë: 06.05.2019, ka parashtruar ankese në OSHP me Nr. të protokollit 201/19.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se bazuar ne nenin4.1pika (b) të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e

tarifave të ankesave thuhet : Periudha kohore për dorëzimin e një kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues 4.1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme: a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. b) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënie të kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.

Andaj OSHP duke pasqyruar faktin se OE ankues brenda afatit ligjor nuk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar ose Njoftimit/ Vendimit për dhënie të kontratës, pas Rivlerësimit që autoriteti kontraktues i ka bërë aktivitetit të prokurimit në fjalë në bazë të kërkesës për Rishqyrtim të njëjtit operator ekonomik konstatojmë se tani operatori ekonomik “Marimanga” ka humbur afatin ligjor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim në autoritetin kontraktues dhe OSHP nuk mund të shqyrtoj ankesën në fjalë për faktin se ankuesi nuk ka parashtruar fillimisht ankesë në organin e shkalles së parë por në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ka parashtruar ankesë direkt në OSHP.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstaton se ankesa e parashtruar me datën: 06.05.2019, nga ana e OE “Marimanga” SHPK- Prishtinë, është e pa lejuar dhe se e njëjta nuk mund të hyn në shqyrtim nga ana e OSHP-së, sepse operatori ekonomik ankues nuk ka parashtruar fare kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-së Njoftimit/Vendimit për dhënie të kontratës në autoritetin kontraktues, të datës: 25.04.2019, e që për të njëjtin aktivitet të prokurimit nuk është udhëhequr një procedurë paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në AK KK Prishtinë.

Paneli Shqyrtues konstaton se ankesa e parashtruar me datë: 06.05.2019 nga OE “Marimanga” në Organin Shqyrtues të Prokurimit është dorëzuar në OSHP në kundërshtim me nenin 9 pika 1 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave sepse neni i lartcekur specifikon se: Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedurë paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

Paneli Shqyrtues ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE “Marimanga ” SH.P.K. Prishtinë, me nr. te protokollit 201/19 dhe ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga operatori ekonomik i cekur si me lart është e pa lejuar për arsyet e dhëna si me lart.

Paneli Shqyrtues, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim Dina



Vendimi i dorëzohet:

1. 1x1 AK- Komuna Prishtinës
2. 1x1 OE “Marimanga”SH.P.K. Prishtinë
3. Arkivës së OSHP-së